



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 962 Prot.

Ballsh, më, 03/03/2025

VENDIM

Nr 07, Datë 25/02 /2025

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PERFORMANCËS SË KËSHILLIT BASHKIAK
MALLAKASTËR PËR VITIN 2024”**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar,” si dhe në bazë të Rregullores së Këshillit Bashkiak, pas shqyrtimit të raportit të paraqitur nga Sekretari i Këshillit Bashkiak për vitin 2024. Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të Këshillit Bashkiak për vitin 2024, i cili përmban analizën e veprimtarisë së institucionit për përmbushjen e detyrave të tij.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak për publikimin e tij në faqen zyrtare të Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”

KRYETAR KËSHILLI
Nexhmi Sulaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 777 Prot.

Ballsh, më 20 / 02 / 2025

**RAPORTI I PERFORMANCËS SË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR PËR
VITIN 2024**

Për vitin 2024, Këshilli i Bashkisë Mallakastër, ka pasur një bashkëpunim të mirë dhe punë intensive në vendimmarrje, duke marr parasysh dhe kërkesat e paraqitura nga qytetarët për t'ju dhënë zë atyre, bazuar në ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, dhe vendimin nr.12, datë 24.02.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër”.

Këshilli Bashkiak, si organ përfaqësues i qeverisë bashkiake, ka tre role kryesore:

1. Përfaqësues;
2. Vendimmarrës;
3. Mbikëqyrës.

Për secilin nga këto role të Këshillit Bashkiak po ju citojmë aktivitetet e kryera si më poshtë vijojnë:

1. Në lidhje me rolin përfaqësues të këshillit për vitin 2024:

Është synuar një komunikim dhe transparencë e vazhdueshme me komunitetin, duke publikuar në rretjet sociale Fecabook, dhe në faqen ëeb: <https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sq/keshilli-bashkiak>, në kohën e duhur njoftimin për çdo mbledhje të këshillit bashkiak dhe duke vënë në dispozicion të gjitha projekt-vendimet e rendit të ditës në faqen ëeb, aktivitetet e këshillit dhe dëgjuesat publike.

Konsultimet Publike – Viti 2024

Në zbatim të vendimit Nr. 51, datë 30.10.2024, mbi “**Planin e Vendimmarrjes, Planin e Konsultimeve Publike dhe Buxhetin e Këshillit Bashkiak Mallakastër për vitin 2024**” ([dokumentacioni i plotë](#)), si dhe bazuar në **Rregulloren e Brendshme për Funksionimin e Këshillit Bashkiak Mallakastër dhe Rregulloren e Konsultimit Publik** (publikuar në [faqen](#)

[zyrtare të Bashkisë Mallakastër](#)), Këshilli Bashkiak Mallakastër ka organizuar dhe zhvilluar me sukses konsultimet publike për projekt-vendimet në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi. **Procesi i Konsultimeve Publike gjatë vitit 2024.**

Në planin e konsultimeve publike janë parashikuar të organizohen konsultime publike për 5 tema;

- **Plani i Buxhetit Afatmesëm 2025-2027**
- **Paketa Fiskale**
- **Buxheti i Bashkisë për vitin 2025**
- Ndryshim buxheti
- Miratim i normave dhe standardeve të shërbimeve publike
- Konsultim për iniciativa qytetare

Buxheti I parashikuar për konsultimet publike ka qenë në vlerën 53.000 lekë, me zëra si letër, bojë për printim dhe mjete kancelarie në funksion të materialeve që do të konsultohen.

Gjatë këtij viti, janë realizuar 4 konsultime publike për 4 projekt-aktesh kryesore:

- **Plani i Buxhetit Afatmesëm 2025-2027**
- **Paketa Fiskale**
- **Buxheti i Bashkisë për vitin 2025**
- **Plani Social Vendor 2024-2027**

Referuar planit, nuk janë realizuar dy konsultime të parashikuara, ndërkohë që është realizuar një konsultim publik (Për Planin Social) që nuk ka qenë i parashikuar në Planin e Konsultimeve publike. Për sa i përket konsultimit publik për iniciativa qytetare, nuk ka patur asnjë të tillë. Por Këshilli bashkiak ka realizuar “Ditën e hapur” me pjesëmarrje të gjerë qytetare. Në këtë mënyrë Plani është realizuar 100%, dhe buxheti për konsultimet publike është shpenzuar 100%,

Gjatë këtyre proceseve janë mbajtur **7 takime publike** me grupet e interesit. Për çdo projekt-vendim janë hartuar dhe publikuar:

- Projekt-vendimet e propozuara,
- Njoftimet për konsultim publik,
- Kalendarët e takimeve (në përputhje me modelin e miratuar në rregulloret e Këshillit Bashkiak),
- Materialet shoqëruese.

Të gjitha këto janë përgatitur dhe publikuar duke respektuar afatet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Pjesëmarrja dhe Dokumentimi i Takimeve Publike

Takimet publike janë mbajtur dhe janë pasqyruar në faqen zyrtare të internetit dhe në rrjetet sociale të Këshillit Bashkiak. Në këto takime kanë marrë pjesë:

- Përfaqësues të Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë,
- Qytetarë dhe banorë nga njësitë administrative,
- Përfaqësues të grupeve të interesit.

Gjatë takimeve publike janë respektuar të gjitha procedurat përkatëse, duke përfshirë:

- Mbajtjen e procesverbaleve,
- Listat e prezencës,
- Dokumentimin me foto.

Të dhëna mbi pjesëmarrjen

Në konsultimin publik, në Njësitë Administrative Fratar, Kutë dhe Selitë, për Hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027, morën pjesë gjithsej **41 persona**, nga të cilët **12 gra**.

Në konsultimin publik, në qytetin e Ballshit dhe Njësitë e tjera Administrative, për Hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027, morën pjesë gjithsej **22 persona**, nga të cilët **7 gra**.

Në konsultimin publik, në qytetin e Ballshit dhe Njësitë e tjera Administrative, për Planin Social Vendor 2024-2027, morën pjesë gjithsej **24 persona**, nga të cilët **13 gra**.

Në konsultimin publik, në Njësitë Administrative Fratar, Kutë dhe Selitë, për hartimin e: Paketa Fiskale 2025, Projekt Buxheti i vitit 2025, Projekt Buxheti Afatmesëm 2025-2027, Shtimi i veprimtarisë së NSHP-së (Prodhim i inarteve), morën pjesë gjithsej **37 persona**, nga të cilët **10 gra**.

Në konsultimin publik, në qytetin e Ballshit dhe Njësitë e tjera Administrative, për hartimin e: Paketa Fiskale 2025, Projekt Buxheti i vitit 2025, Projekt Buxheti Afatmesëm 2025-2027, Shtimi i veprimtarisë së NSHP-së (Prodhim i inarteve), morën pjesë gjithsej **56 persona**, nga të cilët **16 gra**.

Rezultatet dhe Vendimet Përfundimtare

Pas përfundimit të konsultimeve publike dhe zbatimit të procedurave ligjore, Këshilli Bashkiak miratoi projekt-vendimet përkatëse, të cilat më pas morën konfirmimin e ligjshmërisë nga institucioni i Prefektit.

Për më shumë informacion, ju ftojmë të ndiqni publikimet në linket zyrtare të Bashkisë Mallakastër:

- <https://www.facebook.com/share/p/1EvëTBQvT7/>
- <https://www.facebook.com/share/p/15qSj4Uc4k/> dhe <https://bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/Njoftim%3B%20Konsultim%20Publi>

- [k%20per%20Planin%20Social%20Vendor%202024-2027..pdf?fbclid=IëY2xjaëHQHMNleHRuA2FlbQlXMQABHV1RXLIx4NbQ2zGHApvUKK4bgAD9nsKyc3GaeP_YazOYvJ5OxEadëEIJë_aem_zF_O2Lqfj7U4DV_iEf7Vqg](#)
- <https://www.facebook.com/share/p/1EkGELTXvM/> dhe https://bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/Njoftim%20per%20konsultim%20publik%20per%20Buxhetin%202025%2C%20PBA%202025-2027%2C%20Paketn%20Fiskale%2C%20Shtim%20veprimtarie%20e%20NSHP-se.pdf?fbclid=IëY2xjaëHQHP1leHRuA2FlbQlXMAABHdJluT-OeSqMGL77LkoyYq_lgCVRRUslqZëFsOXëJcsKP4cMFErSfDKZuA_aem_9JiVTR54Lliku9YKjhyYg dhe
 - <https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/Projektvendim%20Nr.30%2C%20date%2019.09.2024%20P%C3%ABr%20miratimin%20e%20Planit%20Social%20Vendor%202024-2027.1.pdf>

Në zbatim të rregulloreve të miratuara është vënë në funksionim regjistri fizik i ankesave/kërkesave dhe një regjistër fizik i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbëritura në drejtim të Këshillit të Bashksië.

Konkretisht janë depozituar ne total 30 kërkesa, asnjë ankesë, asnjë peticion, drejtuar Këshillit Bashkiak, gjashtë prej të cilave duke qënë se kanë qënë kompetencë e këshillit është bërë e mundur marrja e vendimeve. Kërkesat e tjera janë trajtuar dhe janë koordinuar me ekzekutivin e bashkisë dhe në të gjitha rastet është kthyer përgjigje brenda afateve dhe procedurave të caktuara.

Referuar Rregullores për strukturat komunitare, Këshilli bashkiak ka realizuar zgjedhjet për Kryetarët e fshatrave. Nga 42 fshatra të Bashkisë Mallakastër, dy janë pa kryetar, në të cilët nuk janë zhvilluar zgjedhjet, për arsye se nuk pranon askush të kandidoj.

Aleancën e Grave Këshilltare ka nxitur dy nisma me bazë gjinore për vitit 2024, të cilat janë realizuar.

- Rikonstruktion i rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Panahor-Subashaj).
- Rikonstruktion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës(Segmenti Qendër Rromës- Lagjia Tabakaj).

Njëkohësisht Aleanca e Grave Këshilltare ka marr një nismë në 2024, e cila pritët te realizohet gjatë vitit 2025.

- Kërkesë për parashikimin e instalimit të kamerave për ambientet dhe sheshet publike dhe arsimore.

2. Në lidhje me rolin vendimarrës, janë kryer aktivitetet si më poshtë:

Gjatë vitit 2024 janë realizuar në total 14 mbledhje të Këshillit, 12 prej tyre të radhës dhe 2 jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë. Gjatë vitit 2024 është mbledhur Kryesia e Këshillit Bashkiak e cila ka vendosur mbi rendin e ditës në secilën mbledhje.

Komisionet e këshillit bashkiak janë mbledhur pesë herë; respektivisht:

- 28.08.2024: Komisioni Juridik, dy anëtarë nga pesë;
- 25.09.2024: Komisioni Juridik, tre anëtarë nga pesë;
- 29.10.2024: Komisioni Juridik, tre anëtarë nga pesë; Komisioni Ekonomik, tre anëtarë nga pesë;
- 26.11.2024: Komisioni Ekonomik, tre anëtarë nga pesë;
- 24.12.2024: Komisioni Juridik, tre anëtarë nga pesë; Komisioni Ekonomik, tre anëtarë nga pesë; Komisioni i Arsimit, tre anëtarë nga pesë.

Në total janë miratuar 72 vendime prej të cilave 17 vendime të konfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, janë shqyrtuar 54 akte individual, 1 vendime të pakonfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Fier.

Gjithashtu, kemi miratuar planin e punës të shoqëruar me planin e konsultimeve dhe buxhetin përkatës të dedikuar vetëm për Këshillin me qëllim përmbushjen e të gjithë aktivitetit të parashikuar.

Fal mbështetjes së projektit "Bashki të forta" nëpërmjet dhurimit të pajisjeve teknologjike, Këshilli i bashkisë Mallakastër ka transmetuar live mbledhjet e këshillit bashkiak, çka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjen madje të jap mendime dhe sygjerime për çështje të ndryshme.

Janë realizuar Dy trajnime:

1. Përfaqësues të komisioneve të Këshillit bashkiak Mallakastër kanë marr pjesë në trajnimin e organizuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), në bashkëpunim me Shoqatën për Autonomi Vendore (SHAV), Shkollën Shqiptare për Administratën Publike (ASPA), Shoqatën e Këshillave të Qarqeve (SHKQSH), me mbështetjen e Projektit "Bashki të Forta" (BtF2) i cili financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Helvetas, u organizua trajnimin për Komisionet e Përherëshme të Këshillit të Bashkisë, në kuadër të përpjekjeve për të mbështetur njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe për të fuqizuar organet e tyre vendimarrëse përmes rritjes së kapaciteteve të këshilltarëve vendorë.

Qëllimi i trajnimit ka konsistuar në fuqizimin e rolit të Komisioneve të Këshillave Bashkiake në shqyrtimin e projekt-akteve, vlerësimin e tyre dhe përgatitjen e raporteve për propozimet ndaj këshilltarëve në seancën e këshillit, me qëllim krijimin e këshillave të suksesshëm, që me rolin e

tyre në mbështetje të administratës së bashkisë dhe nëpërmjet angazhimit të qytetarëve të përkushtuar, do të arrijnë të përmirësojnë sa më shumë demokracinë vendore dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike.

2. Drejtues të Këshillit bashkiak Mallakastër kanë marr pjesë në trajnimin e organizuar në kuadër të iniciativës të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor për të mbështetur fuqizimin e kapaciteteve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV).

Këto trajnime u zhvillohuan në bashkëpunim dhe koordinim me Shoqatën për Autonomi Vendore (SHAV), Shkollën Shqiptare për Administratën Publike (ASPA), Shoqatën e Këshillave të Qarqeve (SHKQSH), Projektin Financat Lokale, me mbështetjen e Projektit “Bashki të Forta”(BtF2) i cili financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Helvetas.

Ky trajnim, si vazhdim i trajnimit përgatitor për këshillarët e rinj dhe komisionet e këshillave, u fokusua në rritjen e kapaciteteve menaxhuese të drejtuesve të këshillave bashkiakë, të cilët kanë përgjegjësinë kryesore për mbarëvajtjen dhe kryerjen e detyrave ligjore të Këshillit.

Pjesëmarrësit kanë marr informacione dhe instrumenta praktike për të përmirësuar punën e tyre në raport me përmbushjen e detyrave, duke u fokusuar në një sërë temash kryesore si: kodi i etikës dhe i sjelljes, aktet që rregullojnë veprimtarinë e brendshme dhe konsultimet me publikun, buxheti i këshillit dhe menaxhimin buxhetor.

3. Aktiviteti sensibilizues dhe ndërgjegjësuës në kuadër të "Tetorit rozë", ardhur si nismë e Aleancës së grave këshilltare, Komisionit të barazisë gjinore, Këshillit bashkiak, në bashkëpunim dhe me mbështetje të bashkisë Mallakastër, Njesisë vendore të kujdesit shëndetësor, me pjesëmarrje të gjerë të grave, vajzave dhe banorëve mallakastriotë.

Gjatë këtij aktiviteti u ndanë informacione me vlerë mbi kujdesin, kontrollet, parandalimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit.

Shpenzimi i buxhetit të këshillit:

- Buxheti për dëgjesat publike;
- Buxheti për aktivitete;
- Buxheti për bashkfinancim për trajnimet;
- Buxheti për realizimin e një vizite studimore me pjesëmarrje të Këshillit bashkiak dhe përfaqësues të bashkisë, në një Këshill/bashki homologe jashtë vendit, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe krijimin e marrdhënieve për bashkëpunime në të ardhmen, **nuk u shpenzuar**, për arsye të afateve kohore procedurale, panvarsisht punës paraprake dhe intensive me komunikimet online dhe materialet përgatitore.
- Buxheti për bilete udhëtimi, për Udhëtim Studimor në Zvicër, sekretari i këshillit të bashkisë Mallakastër u përzgjodh në grupin prej 20 përfaqësuesëve, nga 61 Bashkitë e Shqipërisë.
- Në total nga buxheti i këshilli është shpenzuar 36%.

3. Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit:

Nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruara nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës me rastin e shqyrtimit të gjithë projekt vendimeve të propozuara nga ekzekutivi. Këshilli bashkiak duhet të kerkoj nga administrate raporte sqaruese, çdo tre muaj, mbi ecurinë dhe ekzekutimin e vendimeve të marra nga këshilli.

SEKRETAR KËSHILLIT

ZINAIDA AHMETAJ

